



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1309 prot.

Roskovec, më 28 . 02 .2023

VENDIM

Nr. 18 , datë 27 . 02 .2023

PËR

MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PËRKOHËSISHT TË MJETIT  
TEKNOLOGJIK NË PRONËSI TË BASHKISË ROSKOVEC

Në mbështetje të nenit 9 pika 1 paragrafi 1.2 shkronja “a” dhe “c”, nenit 54 shkronja “e/1” të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, të ndryshuar, si dhe shkresës së Bashkisë Lushnje “Kërkesë për bashkëpunim” me Nr. 1016, datë 06.02.2023 protokolluar në institucionin tonë me Nr. 773, datë 07.02.2023, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin për dhënie në përdorim përkohësisht bashkisë Lushnje për kryerjen e pastrimit të territorit të bashkisë, të pasurisë së luajtshme në pronësi të bashkisë Roskovec, konkretisht të mjetit teknologjik me targa AB 032 HD, marka “Mercedes benz”, modeli “Econic”.
2. Miratimin e draft-marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet bashkisë Roskovec dhe bashkisë Lushnje.
3. Autorizimin e Kryetarit të bashkisë Roskovec për nënshkrimin e kësaj marrëveshje.
4. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike dhe Ndërmarrja e Pastrim, Gjellbërim dhe Mirëmbajtje Varreza me zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR  
Kadri Hyska

